

VENDIM
Nr.626, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 500, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE
TË PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.500, datë 18.7.2003, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Paga e grupit (kolona 2) është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - c) Pika 5/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5/1. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, pas miratimit, rast pas rasti, nga njësia e personelit.”.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të planifikuara, për vitin 2010.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE					
KLASA	EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I - a	Sekretar i përgjithshëm	1	2%		126 000
II - a	Ndihmëskomisioner, kategoria e parë	1	2%		105 000
II- b	Ndihmëskomisioner, kategoria e dytë	1	2%		88 000

	Drejtor drejtorie				
III - a	Përgjegjës sektori	1	2%		71 000
IV - b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		33 000

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë